

# **Raporti Vjetor 2014**

## **nga Sektori i Buxhetit, Financës dhe Shërbimeve Mbeshtetese**

### **I.HYRJE**

Në zbatim të organikës së institucionit, e cila do të paraqitet më poshtë, Instituti i Studimit të Krimeve të Komunizmit është strukturuar në dy drejtori dhe ne nje sektor: Drejtoria e Studimeve Shkencore, Drejtoria e Arkives dhe Sektori i Buxhetit, Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse. Struktura, marrëdhëniet dhe detyrat e këtyre drejtorive, rregullohen përveç legjislacionit dhe akteve nënligjore në fuqi edhe nga rregullorja e brendshme e institucionit, e cila ka përcaktuar në mënyrë të detajuar funksionet, përgjegjësitë dhe procedurat për kryerjen e veprimtarisë së secilës prej këtyre drejtorive dhe sektorit.

Emerimi personelit te institucionit, eshte bere ne zbatim te Ligjit Nr.10242 date 25.02.2010 “Per Institutin e Studimeve per Krimet dhe Pasojat e Komunizmit ne Shqiperi” neni 13 i tij si dhe ne baze te VKM-se nr 191, date 23.02.2011 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Institutit te Studimit te Krimeve dhe Pasojave te Komunizmit ne Shqiperi”, organika e institucionit tonë, ka 15 punonjes.

Për sa më sipër dhe në zbatim të Ligjit Nr. 10468, datë 18.12.2011 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2012”, numri i punonjësve të institucionit të ISKK për vitin 2011, ka qenë 15 punonjës.

#### **ORGANIKA E STRUKTURA E INSTITUCIONIT TË STUDIMEVE PER KRIMET E PASOJAT E KOMUNIZMIT NE SHQIPERI**

POZICIONI	NUMRI
I. DREJTORI EKZEKUTIV	1
SEKRETAR/ARKIVIST	1
II. DREJTORIA E ARKIVES/NENDREJTORI	(4)
DREJTOR DREJTORIE/NENDREJTOR	1
SPECIALIST	3
III. DREJTORIA E STUDIMEVE	(5)
DREJTOR DREJTORIE	1
SPECIALIST	4
IV. SEKTORI I BUXHETIT, FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE	(4)
PERGJEGJES SEKTORI	1
SPECIALIST	2

## II. FAQJA E INTERNETIT

Adresa e internetit te ISKK eshte, [www.iskk.gov.al](http://www.iskk.gov.al), është ndërtuar me krijimin e institucionit, në gjuhën shqip dhe anglisht.

I rëndësishëm për t'u evidentuar është fakti se në adresën e email-it [info@iskk.gov.al](mailto:info@iskk.gov.al) të gjithë të interesuarit mund të drejtojnë pyetje dhe të dergojne informacion qe do te ndihmonte edhe me tej punen studimore te institutit.

## III. BUXHETI

Buxheti mbetet i rendesishem per realizimin e veprimtarisë së institutit . Në funksion të këtij objektivi, buxheti i miratuar për institucionin tonë, në volumin e tij të përgjithshëm, ka qenë si fillim 31.8 milion lekë. Megjithatë, institucioni ynë ka bërë të mundur që nëpërmjet përdorimit me rigorozitet të buxhetit të miratuar, të realizojë tërësisht detyrimet dhe angazhimet e tij.

Megjithëse totali i shpenzimeve është realizuar në masën 84.19% aspekt ky që tregon se realizimi i shpenzimeve eshte ne nivelin maksimal, megjithate mosrealizimi eshte me i ndjeshem ne Shpenzimet Operative . Shpenzimet kapitale te miratuara prej 1.0 milion lekesh jane realizuar ne masen 19.9%. U blene pajisje zyre ne masen 121 mije leke dhe shuma prej 78 mije lekesh u shfrytezua per restaurim zyre. Shfrytezimi ne kete mase i ketij fondi plotesoi disa kerkesa te nevojshme per pajisje zyre per vitin 2014.

Mbështetur në treguesit e realizimit të buxhetit të Institutit tone, për periudhën Janar-Dhjetor 2014, situata buxhetore (plani vjetor dhe realizimi faktik, në lekë e përqindje) paraqitet në tabelat e mëposhtëme:

Artikulli	Plani	Realizimi	Realizimi
-----------	-------	-----------	-----------

	Emërtimi	Vjetor (në mijë lekë)	vjetor (në mijë lekë)	vjetor në %
600	Paga	15,000	14,086	93.91%
601	Sigurime shoq. & shëndet.	3,000	2,121	70.72%
602	Mallra e shërbime të tjera	12,800	10,776	84.19%
600-606	Shpenzime korente	30,800	26,983	87.61%
231	Shpenzime kapitale	1,000	199	19.9%
	<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>31,800</b>	<b>27,182</b>	<b>85.48%</b>

Gjithashtu, në tabelën e mëposhtme, evidentohet pesha e

shpenzimeve sipas artikujve në raport me totalin e shpenzimeve:

Artikulli	Emërtimi	Realizimi vjetor (në mijë lekë)	Realizimi në raport me totalin e shpenzimeve
600	Paga	14,086	51.82%
601	Sigurime shoq. & shëndet.	2,120	7.80%
602	Mallra e shërbime të tjera	10,776	39.65%
231	Shpenzime kapitale	199	0.73%
	Totali i shpenzimeve	27,182	100%

Pergjegjes Sektori

Zoica GRACI

Tirane me 06.02.2015

